

## Miratohet Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 756, datë 23.9.2020 "Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën"

MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

Këshilli i Ministrave ka miratuar ne mbledhjen e radhes proceduren e funksionimit te komisionit Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën. Sipas këtij vendimi, detyrat e këtij komisioni përfshijnë hartimin e standardeve të teksteve mësimore të përbashkëta për Diasporën, hartimin e paketës së dokumenteve për procedurën e konkurrimit për tekste mësimore të përbashkëta për Diasporën, përcaktimin e kriterëve të recensusve të teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën si dhe miratimin e teksteve mësimore të përbashkëta fituese për Diasporën. Ky komision i ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve "Për organizimin e përbashkët të mësimt të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe në përbërje të tij ka përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Kosovës dhe Ministria për Punët e Jashtme dhe Diasporën së Republikës së Kosovës 5 (pesë) përfaqësues si dhe 5 (pesë) përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë dhe ministri i Shtetit për Diasporën.

## Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

## Firmoset marrëveshje bashkëpunimi mes Universitetit të Tiranës dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës



Rrektori i Universitetit të Tiranës, z. Artan Hoxha dhe Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi kanë firmosur një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim zbatimin e Vendimit Nr. 686, datë 02.09.2020 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021". Sipas kësaj marrëveshjeje, Universiteti i Tiranës merr përsipër të ofrojë nëntë kuota pranimi për studentët e huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursë nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020 – 2021. Ndërsa Agjencia Kombëtare e Diasporës merr përsipër të financojë këto bursa në përputhje me kërkesat dhe kushtet financiare të Universitetit të Tiranës si dhe të lehtësojë procedurën për regjistrimin e tyre. Me qëllim mesimin dhe thellimin e njohurive të gjuhës së origjinës do të përfitojnë tre bursa studimi shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Ukraina, dy bursa studimi shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të komunitetit Arbëresh në Itali, dy bursa studimi shtetasit e huaj me origjinë shqiptare në Kroaci dhe dy bursa studimi shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Bullgaria.

## "Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës"



"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës" është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

## Publikohet revista elektronike e bursave për Diasporën në Republikën e Shqipërisë

Revista e bursave për Diasporën në Republikën e Shqipërisë është një botim i veçantë elektronik, i cili përmbledh aktet ligjore dhe nënljgore të miratuara lidhur me bursat për studentët e Diasporës në Republikën e Shqipërisë. Pjesë e kësaj reviste janë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit për dhënie e bursave për studentët e huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursë nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021.



## Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

## Manual për dhënie e bursave dhe përcaktimin e kriterëve, sipas programeve të studimit për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa studimi në Republikën e Shqipërisë.

Agjencia Kombëtare e Diasporës duke patur parasysh objektin e veprimtarisë institucionale, duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit me Diasporën shqiptare me qëllim dhënie e bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, si dhe në përbushje të angazhimeve në kuadër të Vendimit Nr. 686, datë 02.09.2020 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021", ka përgatitur një manual për aplikim për studentët që janë pjesë e komunitetit shqiptar dhe kanë interes të studiojnë në Republikën e Shqipërisë. Në këtë manual mund të gjeni vendet në të cilat shtetasit e huaj me origjinë shqiptare mund të aplikojnë; numrin e bursave sipas vendeve; kriteret bazë si dhe kriteret shtesë për përfitimin e bursës; fushat prioritare të studimit; dokumentat e nevojshëm për aplikim; si dhe mënyrën e përzgjedhjes.



## D Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

## Agjencia Kombëtare e Diasporës nisi drejt Ukrainës dërgesat për Qendrën e Informacionit të Shqipërisë në Universitetin Humanitar Shtetëror të Izmailit



Agjencia Kombëtare e Diasporës në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Universitetin Humanitar Shtetëror të Izmailit, nisi drejt Ukrainës dërgesat e 650 Fjalorëve dygjuhësh Shqip-Ukrainisht të botuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën dhe pajse për Qendrën e Informacionit të Shqipërisë në këtë universitet. Memorandumi i Bashkëpunimit parashikon krijimin e Qendrës së Informacionit të Shqipërisë në Universitetin Humanitar Shtetëror të Izmailit, me qëllim për të nxitur organizimin e aktivitetëve të përbashkëta në ruajtjen e gjuhës shqipe, kulturës, traditave dhe trashëgimisë kulturore shqiptare në Ukrainë. Disa nga detyrat e kësaj qendre janë: Organizimi dhe kryerja e eventeve që synojnë forcimin e bashkëpunimit dypalësh, mësimin e gjuhës shqipe, zhvillimin e kulturës dhe traditave kombëtare të popullit shqiptar; informimin e qytetarëve të Ukrainës për ngjarjet kryesore në sferat publike sociale, ekonomike, kulturore, arsimore të Shqipërisë; krijimin e kushteve për studimin e gjuhës shqipe nga studentët, mësuesit si dhe grupe të interesuara nga jugu i rajonit të Odësës, fillimin dhe realizimin e projekteve të diplomacisë publike dhe kulturore; bashkëpunimin me qendrat e informacionit të shteteve të tjera në kuadër të projekteve të Universitetit Humanitar Shtetëror të Izmailit; bashkëpunimin me institucionet shqiptare për Diasporën për realizimin e detyrave kryesore dhe misionit të saj, etj.

## "Raporto" problemim në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

## Kanada, Greqi, SHBA, Kroaci, mbërrijnë tekste falas nga QBD-ja



Kanada, Greqi, SHBA, Kroaci, mbërrijnë tekste shkollore dhe plotësuese të paracaktuara për mësimdhënie e gjuhës dhe kulturës shqiptare, dërguar falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën arritën tashmë të mësuesit e shkollave shqipe atje, pikërisht në kohën e duhur për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021. Librat, të dërguar nga QBD-ja, nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe të mbërritur përmes MPPJ-së e Postës Shqiptare, në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Kanada. Tekste të ndryshme shkollore, tekste cilësore që kanë shenjuar letërsinë shqipe, seria më e re e botimeve dygjuhëshe nga Qendra e Botimeve për Diasporën, një sërë vlerash, materialeve të ndryshme didaktike, akses online të botimeve tona dhe të platformës së mësimt shqip "Schoolme" janë tashmë në dispozicion të mësuesve për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë.

## QBD, takim me oficeret koordinuese për çështjet e Diasporës shqiptare në Greqi



QBD-ja, mirepritë në mjediset e saj, dy oficeret koordinuese për çështjet e Diasporës shqiptare pranë posteve konsullorë të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në Selanik dhe Athinë, znj. Aurela Konduri dhe znj. Joneda Dodaj. Në takimin e zhvilluar u diskutuan një sërë problematikash lidhur me mesimdhënie në Diasporë, cilësinë e saj, format e mundesit e mijtes së nivelit të saj, si dhe hapja e dritareve të reja në fushën e bashkëpunimit e ndërveprimit, sidomos për lehtësimin e përshatjen e procedurës së regjistrimit të mësuesve, trajnimin e tyre posaçërisht lidhur me nxëniesit dygjuhësh, dhe njohtjen e tyre si aktorë kryesorë e ndërmjetësuesit bazë në përcjelljen e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave oficeret koordinuese të Diasporës do të ushtrjnë funksionin e tyre sipas fushave të paracaktuara si: zhvillimi i marrëdhënieve me komunitetet shqiptare në shtetin pritës, kjo në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, identifikimin e nevojave për arsimimin dhe komunikimin me mësuesit e programeve plotësuese të gjuhës e të kulturës shqiptare në bashkëpunim me Qendrën e Botimit të Diasporës, nxitjen dhe organizimin e bizneseve shqiptare në vendin pritës në bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës si dhe identifikimin dhe asistimin e shtetasve shqiptarë, të cilët vuajnë dënimin me heqje të lirisë në shtetin pritës në bashkëpunim me ministri në përgjegjësi për drejtësinë.

Për më shumë informacione nga Diaspora vizitoni:

[www.diasporashqiptare.al](http://www.diasporashqiptare.al)